



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**  
**BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nr. 620/3 prot.

Elbasan, me 06.03.2021

**VENDIM**

Nr. 11 datë 06.03.2021

**PËR**  
**PAGESËN E ORËVE SUPLEMENTARE TË VITIT AKADEMIK 2020-2021**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; ligjit nr. 137 date 16.11.2020 "Për buxhetin e vitit 2021", Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar; Udhëzimit të përbashkët Nr. 20 datë 20.09.2019 të MASR dhe MFE " Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor"; VKM-së Nr.75 datë 12.02.2018 " Për miratimin e modeli të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL", shkresës së MASR (Email) datë 04.01.2021 në të cilin jepen fondet e miratuara për vitin 2021, për efekt të ndjekjes së likuiditeteve në fushën e menaxhimit, Shkresa e MFE nr. 20/1 prot, datë 14.01.2021 "Dërgohet detajimi i grantit për vitin 2021", Vendimit të Senatit Akademik Nr. 6, datë 26.02.2021 "Për miratimin e plan buxhetit vjetor 2021", Bordi i Administrimit në mbledhjen Tij të datës 06.03.2021,

**VENDOSI:**

1. Personelit akademik të punësuar me kohë të plotë t'i paguhen deri në 300 orë suplementare të realizuara mbi normën e ngarkesës në auditor (e online), pasi të ketë përmbushur kohën minimale vjetore të punës prej 1,536 orë.
2. Personelit akademik të punësuar me kohë të plotë (trajnesit) të paguhen deri në 100 orë (trajnimi të punonjësve arsimore), brenda limitit të përcaktuar veprimtari jashtë auditori, pasi të jetë realizuar norma e ngarkesës së përcaktuar në veprimtarinë akademike dhe të jetë përmbushur koha minimale vjetore e punës prej 1,536 orë, jo më shumë se përcaktimet në pikën 1.
3. Fondi për këtë pagesë të përballohet nga granti i parashikuar për shpenzimet e pagave të punonjësve për vitin 2021.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi: Administratori i Universitetit "Aleksandër Xhuvani", Njësitë kryesore, Njësitë bazë.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BORDIT**

**ARDIAN DURMISHI**